

 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	0113	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No:	1217
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	1	Data Datum Date:	06.06.16
PRISHTINË/A			

**Operator Transmisioni, Sistemi dhe Tregu sh.a
KOSTT**

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe për periudhën që përfundoi
më 31 dhjetor 2015**

PËRMBAJTJA	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	5
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	6 - 33

Raporti i Auditorit të Pavarur

Bordit të Drejtorëve të Operatorit të Transmisionit, Sistemit dhe të Tregut – KOSTT sh.a

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura të Operatorit të Transmisionit, Sistemit dhe të Tregut "KOSTT SH.A." ("Kompania") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2015, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar më këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgaditjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përmbanë: dizajnimin, implementimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm lidhur me përgaditjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve; selektimin dhe zbatimin e politikave të përshtatshme të kontabilitetit; si dhe vlersimet kontabël që janë të arsyeshme me rrethanat.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare, bazuar në auditimin tonë. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që të jemi në përputhje me kërkesat etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave për vlerat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistimit të gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr parasysh kontrollet e brendshme relevante për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të dizajnojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë më 31 dhjetor 2015, si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.



Prishtina, Kosova
29 prill 2016

OPERATORI I TRANSIMISIONIT, SISTEMIT DHE TREGUT – KOSTT SH.A.**Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015***(shumat në '000 Euro)*

		Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
	Shënim		
PASURIA			
Pasuria afatgjatë			
Prona, impiantet dhe paisjet	4	155,811	129,258
Pasuritë e paprekëshme	5	1,094	1,280
		<u>156,905</u>	<u>130,538</u>
Pasuria afatshkurtër			
Inventari	6	3,345	2,604
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	7	2,517	1,976
Të arkëtueshmet tjera	8	9,435	9,082
Investimet në kompanitë tjera	9	68	68
Paraja e gatshme dhe në bankë	10	26,436	23,511
		<u>41,801</u>	<u>37,241</u>
GJITHSEJ PASURIA		<u>198,706</u>	<u>167,779</u>
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Kapitali i aksionarëve			
Kapitali aksionar	11	25	25
Rezervat e transferit	12	53,322	53,322
Fitimi i mbajtur		23,086	18,714
Fitimi për periudhën		6,823	4,372
		<u>83,256</u>	<u>76,433</u>
Detyrimet afatgjata			
Grantet e shtyera	13	89,275	82,417
Borxhi afatgjatë	14	16,042	-
		<u>105,317</u>	<u>82,417</u>
Detyrimet afatshkurtëra			
Të pagueshme tregtare dhe të tjera	15	9,024	7,648
Tatimi i shtyrë	24	1,109	1,281
		<u>10,133</u>	<u>8,929</u>
GJITHSEJ DETYRIMET		<u>115,450</u>	<u>91,346</u>
GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI		<u>198,706</u>	<u>167,779</u>

Të autorizuar për lëshim nga Bordi i Drejtorëve me 11 mars 2016 dhe të nënshkruara në emër të tyre nga menaxhmenti më 29 Prill 2016.

Z. Mustafe Hasani**Drejtore Ekzekutiv****Z. Nebih Haziri****Drejtore Financiar**

Shënimet shoqëruese prej faqes 6 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

OPERATORI I TRANSMISIONIT, SISTEMIT DHE TREGUT – KOSTT SH.A.
Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

	Shënim	Për fund vitin 31 dhjetor 2015	Për fund vitin 31 dhjetor 2014
Të hyrat			
Transmisioni i energjisë	16	23,861	18,845
Të hyrat tjera	17	6,446	6,439
		30,307	25,284
Shpenzimet operative			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	4-5	10,405	10,052
Shpenzimet e personelit	18	5,103	5,014
Humbja në transmisionin e energjisë	19	3,076	3,063
Shpenzimet tjera operative	21	1,719	1,790
Riparimi dhe mirëmbajtja	20	612	813
		20,915	20,732
Fitimi operativ		9,392	4,552
Shpenzimet jo-operative			
Provizioni për TVSH e arkëtueshme	22a	710	-
Taksat dhe gjobat	22b	882	-
Fitimi para tatimit dhe interesit		7,800	4,552
Të hyrat financiare (shpenzimet)	23	284	481
Fitimi para tatimit		8,084	5,033
Tatimi në fitim të korporatave	24	1,261	661
Fitimi neto për vitin		6,823	4,372
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhura gjithëpërfshirëse		6,823	4,372

Shënimet shoqëruese prej faqes 6 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut -- KOSTT SH.A.
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

	Kapitali aksionar	Rezervat e transferit	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 Janar 2014	25	53,172	18,714	71,911
Fitimi për vitin	-	-	4,372	4,372
Shtesat		150	-	150
Dividenta		-	-	-
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	25	53,322	23,086	76,433
Shtesat	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	6,823	6,823
Gjendja më 31 dhjetor 2015	25	53,322	29,909	83,256

Shënimet shoqëruese prej faqes 6 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

	Shënim	Për fund vitin 31 Dhjetor 2015	Për fund vitin 31 Dhjetor 2014
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		8,084	5,033
<i>Rregullimet për:</i>			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	4&5	10,405	10,052
Të ardhurat nga interesi	23	(284)	(481)
Të ardhurat nga grantet	13	(6,407)	(6,399)
Fitimi para ndryshimeve në asetet dhe detyrimet operative		11,798	8,205
Zvogëlimi / (ritja) në inventar		(741)	(10)
Zvogëlimi / (ritja) në të arkëtueshmet tregtare		(2,718)	95
Zvogëlimi / (ritja) në të arkëtueshmet tjera		984	(5,249)
Zvogëlimi / (ritja) në të pagueshmet tregtare dhe të tjera		(433)	6,313
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet Operative		8,891	9,354
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Interesi i pranuar		284	481
Blerja e pronës, impianteve dhe paisjeve dhe pasuri te paprekshem		(19,867)	(13,719)
Rritja/zvogëlimi në investime në kompanitë tjera		-	(40)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet Investuese		(19,583)	(13,278)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Grantet e pranuar		13,618	5,928
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet Financuese		13,618	5,928
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	10	23,511	21,507
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	10	26,436	23,511

Shënimet shoqëruese prej faqes 6 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015

(shumat në '000 Euro)

1. INFORMATA TË PËRGJITHSIIME

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut (më tej "Kompania" ose "KOSTT SH.A."), ishte inkorporuar si një entitet i pavarur më 23 dhjetor 2005 nga transformimi i Korporatës Energjetike të Kosovës ("KEK") dhe ishte regjistruar si shoqëri aksionare sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/6 me datën 8 Shkurt 2001 në Organizatat Biznesore ("Rregulloja") me numër të regjistrimit të biznesit 70325350.

Kompania filloi të operojë në mënyrë të pavarur nga 1 Korrik 2006 sipas marrëveshjes në mes të KEK SH.A. dhe KOSTT SH.A. lidhur me marrëdhëniet tranzicionale, komerciale dhe operacionale në mes të KEK SH.A. dhe KOSTT SH.A. për transferimin e përgjegjësiave mbi operimet dhe mirëmbajtjen e rrjetit të Transmisionit të KOSTT SH.A.

Adresa e zyrës së Kompanisë është "Ndërtesa e Transmisionit dhe Dërgimit, Iljaz Kodra, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Kompania është në pronësi të Operatorit të Transmisionit, Sistemit dhe Tregut Sh.a. Kosova ka shpallur pavarësinë e saj më 17 Shkurt 2008. Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-087 të datës 13 Qershor 2008 në "Ligji mbi Ndërmarrjet në Pronësi Publike", Sistemi i Transmisionit dhe Operatori i Tregut SH.A. është në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Aktivitetet kryesore të kompanisë janë menaxhimi dhe operimi i sistemit të transmisionit të energjisë të Kosovës dhe është përgjegjëse për transmisionin e energjisë tek rrjetet elektrike me voltazhë të lartë. Si operator tregu Kompania është përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e tregtisë së energjisë dhe gjithashtu menaxhon procesin e marrëveshjeve.

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, monedhë të cilën e përdor Kompania për t'i kryer funksionet e saj.

Më 31 dhjetor 2015 Kompania ka 351 punonjës (2014: 359).

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive për periudhën aktuale

Ndryshimet e mëposhtme të standardeve ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e lëshuara nga Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për Raportimin Financiar janë në fuqi për periudhën aktuale:

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshime në SNK 19 "Përfitimet e punonjësve"** - Planet e përfitimit të definuara: Kontributet e punonjësve (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2014);
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2010-2012)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 2, SNRF 3, SNRF 8, SNRF 13, SNK 16, SNK 24 dhe SNK 38) kryesisht me qëllim të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 korrikut 2014);
- **Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2011-2013)"** që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 13 dhe SNK 40) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet janë që do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 korrik 2014)

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
*(shumat në *000 Euro)*

2. ADOPTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (VAZHIDIM)

2.2 Standardet dhe interpretimet të lëshuara por ende jo te adoptuara

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, ndryshimet në standardet dhe interpretimet ekzistuese janë publikuar, por ende jo efektive:

- SNRF 9 "Instrumentet financiare" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018);
- SNRF 14 "Llogaritë rregullatore të shtyrjes" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët" dhe ndryshime të mëtejshme (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018);
- IFRS 16 "Qiratë" (efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019);
- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Shitja apo Kontributi i aseteve në mes të një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (data efektive është shtyrë për kohë të pacaktuar deri një projekt kërkimor në metoda të kapitalit neto është përfunduar);
- Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Shpalosja e interesave në entitetet e tjera" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Njësitë Ekonomike Investuese: Aplikimi përjashtim Consolidation (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 January 2016);
- Ndryshimet në SNRF 11 "Marrëveshjet e përbashkëta" - Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" - Iniciativa Disclosure (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e rrjedhjes së parasë së gatshme" – Shpalosjet (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017);
- Ndryshime në SNK 12 "Tatimet mbi të Ardhurat" - njohjen e pasurive tatimore të shtyra për humbjet e përealizuara (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017);
- Ndryshime në SNK 16 "Pronat Afatgjata Materiale" dhe SNK 38 "Pasuritë Jo-materiale" - Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimi dhe amortizimi (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- Ndryshime në SNK 16 "Pronat Afatgjata Materiale" dhe SNK 41 "Bujqësia" - Bujqësi: Bujqësi: bartës të bimëve (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- Ndryshime në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale", - metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare individuale (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016);
- Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2012-2014)" që rezultojnë nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (ndryshimet janë që do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).

Kompania ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datave të tyre të hyrjes në fuqi. Kompania parashikon që adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare në periudhën e zbatimit fillestar.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL

3.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të bashkangjitura janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

3.2 Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë prezantuar në EURO, e cila është edhe monedha funksionale e Kompanisë.

3.4 Bazat e përgaditjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur nën koventën e kostos historike. Bazat e matjes janë përshkruar më detajisht në politikat e kontabilitetit më poshtë.

3.4 Transaksionet në monedhë të huaj

Në fund të çdo periudhe të raportimit, zërat monetarë të mbajtur në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me normat që mbizotërojnë në atë datë. Zëra jomonetarë të mbajtur me vlerë të drejtë që janë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zëra jo monetarë që janë matur në terma të kostos historike në monedhë të huaj nuk rikonvertohen.

Diferencat e këmbimit për zërat monetarë njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin me përjashtim të:

- Diferencave të këmbimit nga huamarrjet në monedhë të huaj që lidhen me pasuritë në ndërtim e sipër për përdorim produktiv në të ardhmen, të cilat janë të përfshira në koston e këtyre pasurive, kur ata konsiderohen si një rregullim i kostove të interesit për ato huamarrje në monedhë të huaj.
- Diferencave të këmbimit për transaksionet e ndërmarra me qëllim të mbrojtjes nga rreziqet e ndryshme të monedhave të huaja; dhe
- Diferencat e këmbimit për zërat monetarë të arkëtueshme nga ose të pagueshme ndaj një operacioni në valutë huaj për të cilin shlyerja nuk është planifikuar dhe as ka gjasa për të ndodhur (pra, duke formuar pjesë të investimit neto në operacionin në valutë të huaj), të cilat janë njohur fillimisht në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe të riklasifikuara nga kapitali në fitim ose humbje në shlyerjen e detyrimit të zërave monetare.

3.5 Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të Kompanisë përbëjnë llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera, paranë dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera dhe kreditë dhe huamarrjet që mbartin interes. Instrumente të tilla financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus ndonjë shpenzim që i atribuohet drejtëpërdrejt transaksionit.

Pas njohjes fillestare:

- instrumentet financiare që nuk mbartin interes maten me kosto, duke i zbritur ndonjë humbje nga rënia në vlerë;
- instrumentet financiare që mbartin interes maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, dhe duke i zbritur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një pasurie financiare ose një detyrimi financiar (ose një grupi pasurish ose detyrimesh financiare) dhe për shpërndarjen e të

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHIDIM)

3.5 Instrumentet financiare (vazhdim)

ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit në periudhën përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat ose arkëtimet monetare të ardhshme të vlerësuara me anë të jetës së pritshme të instrumentit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më të shkurtër për vlerën bartëse neto të pasurisë ose detyrimit financiar.

3.6 Pronat, impiantet dhe paisjet

Pronat, impiantet dhe paisjet maten me kosto duke i zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejtë të ngarkueshme me blerjen e pasurisë.

Kosto e pasurive të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë (nëse është përfshirë), ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e pasurisë në gjendjen funksionale për përdorimin e synuar. Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të veçantë (përbërësit madhor) të pronës, impianteve dhe pajisjeve.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të pasurive afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të pasurive afatgjata materiale dhe njihen neto brenda "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave (në fitim ose humbje).

Pronat në rrjedhën e ndërtimit për prodhim, ose për çështje administrative, ose për qëllime ende të papërcaktuara, barten në kosto, minus çdo humbje nga zhvlerësimi e njohur. Kosto përfshinë tarifatat profesionale dhe, për pasuritë e kualifikuara, koston e huamarrjes kapitalizohen në përputhje me politikën kontabël të kompanisë. Zhvlerësimi i këtyre pasurive, në të njëjtën bazë si aktivet e tjera të pronësisë, fillon kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar.

Mobilet, orenditë, paisjet dhe automjetet paraqiten me koston e tyre pa zhvlerësim të akumuluar dhe pa humbjet e akumuluar nga dëmtimet.

Zhvlerësimi ngarkohet në atë mënyrë që të zvogëlojë koston ose vlerësimin e pasurive, përveç Tokës dhe pronave në ndërtim e sipër, gjatë jetës së tyre të vlerësuar të përdorimit, duke përdorur metodën lineare, si vijon:

Ndërtcsat dhe rrjeti i transmisionit	2-50 vite
Impiantet dhe makineritë	7-15 vite
Mobilet, paisjet	2-16 vite
Vetura	5-10 vite

Në bazë të shtesave dhe hudhjeve gjatë vitit, zhvlerësimi ngarkohet prej muajit të blerjes deri te muaji përkatës i asgjësimit.

Jetët e vlerësuara të përdorimit, vlerat e mbetura dhe metodat e zhvlerësimit rishikohen në çdo fund vit, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësimet kontabël në të ardhmen.

Fitimi ose humbja që vjen nga hudhja apo asgjësimi të ndonjë pjese të pronave, impianteve ose paisjeve përcaktohet si një diferencë në mes të të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël të një asemi dhe është e njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Kostot pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si pasuri e ndarë, sipas rastit, sipas nevojës, vetëm atëherë kur është e mundur që përfitimet ekonomike në të ardhmen të lidhura me atë artikull do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e artikullit mund të matet në mënyrë të sigurt. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet tjera paraqiten në pasqyrën e ardhurave ose humbjeve dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.7 Pasuritë e paprekshme

Njohja dhe matja

Pasuritë e paprekshme përbëhen nga licencat dhe programet kompjuterike. Këto pasuri të paprekshme janë paraqitur fillimisht me kosto dhe më pas me koston e tyre duke i zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë. Amortizimi është njohur në bazë lineare përgjatë jetës së pritshme të përdorimit. Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësim duke u llogaritur në baza të ardhme.

Shpenzimet pasuese

Shpenzimet pasuese janë kapitalizuar vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilën ato lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera, përfshirë shpenzimet për emrin e mirë të krijuar brenda, njihet në fitim ose humbje në momentin kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e pasurisë, duke i zbritur vlerën e saj të mbetur. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare për softver me një normë vjetore prej 20%.

3.8 Inventari

Inventarët maten me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve është e bazuar në parimin e "çmimit mesatar", dhe përfshin shpenzimet e shkaktuara me rastin e blerjes së inventarëve, koston e prodhimit apo të konvertimit dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara në sjelljen e tyre në vendin dhe gjendjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus koston e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.

Materialet dhe pjesët rezervë janë shpenzuar ose kapitalizuar, kur instalohen.

Një provizion për inventar me qarkullim të ulët dhe inventarë të vjetëruar njihet në pasqyrën e të ardhurave, bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhimit.

3.9 Instrumentet financiare

Kompania fillimisht njihet të arkëtueshmet dhe depozitimet e parasë në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha pasuritë e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregimit në të cilën kompania bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Kompania regjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat e marrjes së rrjedhës monetare nga pasuria financiare në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga Kompania është e njohur si një pasuri apo detyrim i veçantë.

Pasuritë dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë, dhe vetëm atëherë kur, Kompania ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose të shlyejë mbi një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrim në të njëjtën kohë. Instrumentet financiare jo-derivative të kompanisë përbëjnë të arkëtueshme të tjera, paranë dhe ekuivalentët e saj, dhe të pagueshmet tregtare dhe të tjera.

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë bilancet e parave të gatshme, llogaritë bankare dhe depozitat me afat, me afat maturimi më pak se tre muaj.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare regjistrohen fillimisht në shumën e arkëtueshme kundrejtë shitjes së produkteve. Në vazhdimësi, llogaritë e arkëtueshme paraqiten me koston e tyre nominale duke i zbritur provizionet për borxhet e dyshimta.

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Instrumentet tjera financiare

Instrumente të tjera jo-derivative janë matur me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv, minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionarë

Kapitali aksionar i Kompanisë njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë të klasifikuara si kapital.

3.10 Rënia në vlerë

Pasuritë financiare

Pasuritë financiare janë vlerësuar për indikacione të rënies në vlerë në fund të çdo periudhe raportuese. Pasuritë financiare bie në vlerë kur ka evidencë objektive që, si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë financiare, flukset e vlerësuara monetare të ardhshme të investimit janë ndikuar.

Humbja nga rënia në vlerë e një pasurie financiare të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferenca midis vlerës së saj kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të vlerësuara të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Për pasuritë financiare të matura me kosto, vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare është llogaritur duke përdorur normën e tregut të kthimit për pasuri të ngjashme.

Pasuritë financiare të rëndësishme janë testuar për rënie në vlerë në baza individuale.

Pasuritë financiare të mbetura vlerësohen kolektivisht në grupe që ndajnë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë. Të gjitha humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje). Humbja nga rënia në vlerë rimerrret nëse ky kthim mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga rënia në vlerë është njohur. Për pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar kthimi është njohur në të të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse (në fitim ose humbje).

Pasuritë jo financiare

Në fund të çdo periudhe raportimi, Kompania rishikon vlerat kontabël të pasurive të saj jo financiare, përveç inventarëve dhe tatimit të shtyrë pasuri, për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar një humbje nga rënia në vlerë.

Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë në mënyrë që të përcaktohet shkalla e humbjes (nëse ka). Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është shuma më e madhe në mes të vlerës së saj në përdorim ose vlerës së saj të drejtë minus kostot për shitje.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.10 Rënia në vlerë (vazhdim)

Pasuritë jo financiare (vazhdim)

Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për pasurinë. Për qëllim të testimit të rënies në vlerë, pasuritë grupohen së bashku në grupin më të vogël të pasurive që gjeneron flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhduar që janë kryesisht të pavarura nga flukset monetare hyrëse të pasurive të tjera ose grupeve të pasurive ("njësi gjeneruese të mjeteve monetare").

Humbja nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje).

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHIDIM)

3.11 Grantet qeveritare

Një grant qeveritar njihet vetëm atëherë kur ekziston një siguri e arsyeshme mbi kushtet prej të cilave përbëhet granti dhe që granti do të pranohet.

Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës që nevojitet të përputhet e ardhura me kostot e lidhura, për të cilat ata janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike.

Nëse një grant bëhet i ripagueshëm, duhet të trajtohet si një ndryshim në vlerësimin. Kur granti është i lidhur me të ardhurat, shlyerja duhet të zbatohet fillimisht kundër ndonjë detyrimi të lidhur të paamortizuar të shtyrë, dhe çdo tejkallim duhet të trajtohet si shpenzime. Kur granti ndërlihet me një pasuri, shlyerja duhet të trajtohet si rritje në vlerën kontabël të pasurisë ose zvogëlimin në bilancin e të ardhurave të shtyera. Amortizimi kumulativ që do të ishte ngarkuar nëse granti nuk do të ishte pranuar, duhet të ngarkohet si shpenzim.

Një grant i arkëtueshëm si kompensim për shpenzimet e bëra tashmë ose për mbështetje të menjëhershme financiare, pa shpenzimet e lidhura me të ardhmen, duhet të njihet si e ardhur në periudhën në të cilën ai është i arkëtueshëm.

Përfitimi i një granti në një normë të ulët të interesit të tregut, trajtohet si një grant qeveritar, i matur nga diferenca midis të ardhurave të pranuar dhe vlerat e drejta të kredisë të bazuar në normat aktuale të interesit të tregut.

3.12 Detyrimet financiare

Detyrimet financiare përfshijnë huamarrjet dhe llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera që maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse.

Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat e vlerësuara monetare të ardhshme (duke përfshirë të gjitha shumat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës së interesit efektiv, kostot e transaksionit dhe primet e tjera ose uljet) nëpërmjet jetës së detyrimit financiar, ose (sipas rastit) një periudhë më të shkurtër, në vlerën bartëse neto në njohjen fillestare

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.13 Njohja e të hyrave

Të ardhurat njihen me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme.

Kur rezultati i një transaksioni që përfshin kryerjen e shërbimeve mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, të ardhurat e lidhura me transaksionin do të njihen duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese. Rezultati i një transaksioni mund të vlerësohet i besueshëm kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë përmbushur:

- (a) shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme;
- (b) është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të rrjedhin tek njësia ekonomike;
- (c) faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet në mënyrë të besueshme; dhe
- (d) kostot e shkaktuara për transaksionin dhe kostot për të përfunduar transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme.

3.14 Përfitimet e punëtorëve

Kompania, në rrjedhën normale të biznesit, kryen pagesa në emër të vet dhe në emër të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionin e detyrueshëm sipas legjislacionit lokal. Shpenzimet e bëra në emër të Kompanisë janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

3.15 Provizionet

Provizionet njihen kur Kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundshme që Kompania do të kërkohej për të shlyer detyrimin, dhe një vlerësim i besueshëm mund t'i bëhet shumës së detyrimit.

Shuma e njohur si provizion është vlerësimi më i mirë i shumës që kërkohej për të shlyer detyrimin aktual në datën e bilancit, duke marrë parasysh rreziqet dhe pasiguritë që rrethojnë detyrimin. Kur një provizion matet duke përdorur rrjedhat e vlerësuara të flukseve monetare të nevojitura për të shlyer detyrimin aktual, vlera e tij kontabël është vlera aktuale e këtyre flukseve të mjeteve monetare (kur efekti i vlerës në kohë të pasasë është material).

Kur disa ose të gjitha përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer një provizion pritet që të rikthehen nga një palë e tretë, një e arkëtueshme njihet si një pasuri nëse është pothuajse e sigurt që rimbursimi do të merret dhe shuma e arkëtueshme mund të matet në mënyrë të besueshme.

3.16 Kontratat me kushte të pavolitëshme

Detyrimet aktuale që lindin nën kontratat me kushte të pavolitëshme njihen dhe maten si provizione. Një kontratë me kushte të pavolitëshme është konsideruar të ekzistojë kur Kompania ka një kontratë në të cilën kostot e pashmangshme të përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës tejkalojnë përfitimet ekonomike që priten të pranohen nga kontrata.

Para se një provizion i veçantë për një kontratë me kushte të pavolitëshme është themeluar, një kompani njihet çdo humbje nga zhvlerësimi që ka ndodhur mbi pasuritë dedikuar për këtë kontratë.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut – KOSTT SH.A.
Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2015
(shumat në '000 Euro)

3. POLITIKA TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

3.17 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të hyrat e interesit mbi llogaritë rrjedhëse. Të ardhurat nga interesi njihen kur ato ndodhin në pasqyrën e të ardhurave (fitim ose humbje), duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit mbi huazimet, dhe humbjet nga rënia në vlerë të njohura në pasuri financiare, (nëse ka).

3.18 Shpenzimet e huamarrjes

Kostot e huamarrjes drejtpërdrejt të atribuueshme për blerjen, ndërtimin ose prodhimin e pasurive të ndërlydhura, të cilat janë pasuri që domosdoshmërisht marrin një kohë të gjatë për të qënë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar ose të shitjes, janë shtuar në koston e këtyre pasurive, deri në kohën kur pasuritë janë të gatshme për përdorimin e tyre të synuar apo për shitje.

Të gjitha shpenzimet e tjera të huamarrjes njihen në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato ndodhin.

3.19 Tatimi

Tatimi mbi fitimin paraqet shumën e tatimit aktualisht të pagueshëm dhe tatimin e shtyrë.

Shpenzimi mbi tatimin në fitim përfshin tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual është tatimi që pritet për t'u paguar ose arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen për vitin, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndjekin mënyrën në të cilën kompania pret, në fund të periudhës raportuese, për të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve të saj. Tatimi i shtyrë është matur në norma të tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato të ndryshojnë, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e miratuar në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë si pasuri njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoret ndryshimi i përkohshëm. Tatim i shtyrë si pasuri rishikohet në secilën datë të raportimit dhe reduktohet në masën që kjo nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

